

You can't
shape
London's
future.

Diçka e vogël X mund të sjellë
ndryshim të madh.

Lini gjurmën tuaj në **zgjedhjet e
Kryebashkiakut të Londrës
dhe të Asamblesë së Londrës.**

2 maj 2024

Merrni me vete mjet
identifikimi me fotografi
për të votuar.

Mësoni më shumë në
londonelects.org.uk

**LONDON
ELECTS**



Më 2 maj 2024, njerëzit që jetojnë në Londër mund të votojnë për Kryebashkiakun e Londrës dhe për 25 Anëtarët e Asamblesë së Londrës.

Puna e kryebashkiakut është që ta bëjë Londrën një vend më të mirë për të gjithë njerëzit që vizitojnë, jetojnë ose punojnë në qytet.

Këtu përfshihen zhvillimi i politikave, përcaktimi i buxheteve, mbikëqyrja e programeve të kryetarit të bashkisë dhe përkrahja e Londrës anembanë botës – të gjitha në përputhje me vizionin dhe interesat e Londrës dhe të londinezëve.

Asambleja e Londrës përbëhet nga deri në 25 anëtarë – 11 përfaqësojnë të gjithë kryeqytetin dhe 14 janë të zgjedhur nga 14 zonat elektorale të Londrës.

Asambleja ka përgjegjësi të jetë syri dhe veshi i londinezëve në bashkinë e qytetit. Anëtarët i kërkojnë përgjegjësi kryebashkiakut duke shqyrtuar strategjitë, vendimet dhe veprimet e kryebashkiakut për t'u siguruar që të jenë në përputhje me interesat e publikut.

KUR TË VOTONI

Qendrat e votimit do të hapen më 2 maj 2024 nga ora 07:00 deri në 22:00. Është mirë të vinë kohë përpara që të votoni. **Duhet të merrni me vete mjet identifikimi me fotografi që të votoni. Mësoni më shumë në faqen vijuese.** Nëse do të votoni me postë, do të merrni fletët e votimit para ditës së zgjedhjeve. Duhet t'i dërgoni ato para orës 22:00 më 2 maj 2024.

KUSH MUND TË VOTOJË

Mund të votoni nëse jeni:

- 18 vjeç e sipër më 2 maj 2024
- shtetas kualifikues britanik, i BE-së ose i Komonuelthit që jeton në Londër dhe i regjistruar për të votuar deri më 16 prill 2024

Mund të regjistroheni për të votuar në gov.uk/register-to-vote ose mund të kontaktoni zyrën e regjistrimit elektorale të qarkut tuaj.

KU TË VOTONI

Ka 3 mënyra si mund të votoni.



1 Në qendrën e votimit:

- Para datës 2 maj do të merrni një fletë votimi me hollësi për qendrën tuaj të votimit.
- Mund të votoni vetëm në qendrën e votimit që tregohet në këtë kartë.
- Stafi i qendrës së votimit do t'ju kërkojë të tregoni mjetin e identifikimit me fotografi. Ata do të kontrollojnë që ju jeni vërtet personi gjendet në fotografinë e mjetit të identifikimit, dhe që emri juaj gjendet në regjistrin elektorale.
- Stafi në qendrën e votimit mund t'ju ndihmojë të kupton fletët e votimit nëse keni nevojë.
- Nuk jeni të detyruar të merrni me vete fletën e votimit në qendrën e votimit, megjithatë kjo do të ndihmonte stafin.

Format e pranuar të mjetit të identifikimit me fotografi.

Mund të përdorni cilëndo prej formave të mëposhtme të mjetit të identifikimit me fotografi në një qendër votimi.

Udhëtim ndërkombëtar

Pasaportë e nxjerrë në Mbretërinë e Bashkuar, në cilindo prej Ishujve të Kanalit, në Ishullin e Njeriut, në një Territor Britanik të Jashtëm, një shtet të Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE) ose një shtet të Komonuelthit (duke përfshirë Kartën e Pasaportës Irlandeze).

Drejtimi i automjetit dhe parkimi

Leje drejtimi e nxjerrë në Mbretërinë e Bashkuar, në cilindo prej Ishujve të Kanalit, në Ishullin e Njeriut, ose në një shtet të ZEE (këtu përfshihen lejet e drejtimit të përkohshme) A Blue Badge.

Udhëtimet lokale

- Bileta autobusi për të moshuar të financuara nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar
- Bileta autobusi për personat me aftësi të kufizuara të financuara nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar
- Kartë Oyster 60+ e financuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar
- Freedom Pass
- Kartë e të drejtës kombëtare Skoceze e dhënë për udhëtime koncesionare (duke përfshirë biletë autobusi për personat mbi 60 vjeç, me aftësi të kufizuara ose nën 22 vjeç)
- Kartë udhëtimi koncesionare e Uellsit për personat 60 vjeç e sipër
- Kartë udhëtimi koncesionare e Uellsit për personat me aftësi të kufizuara
- SmartPass për të moshuar e nxjerrë në Irlandën e Veriut
- SmartPass për të verbër të regjistruar ose SmartPass për persona të verbër e nxjerrë në Irlandën e Veriut
- SmartPass për persona të dëmtuar në luftë e nxjerrë në Irlandën e Veriut
- SmartPass për persona 60 vjeç e sipër e nxjerrë në Irlandën e Veriut
- SmartPass me tarifë përgjysmë e nxjerrë në Irlandën e Veriut

Vërtetim moshe

Kartë identiteti që ka hologramin e skemës së standardeve për vërtetimin e moshës (kartë PASS).

Dokumente të tjera të dhëna nga qeveria

- Dokument biometrik i emigracionit
- Kartë identiteti kombëtare e nxjerrë nga një shtet i ZEE
- Kartë identiteti elektoral e nxjerrë në Irlandën e Veriut

Certifikatë e autoritetit të votuesit: <https://www.electoralcommission.org.uk/i-am-a/voter/voter-id/applying-a-voter-authority-certificate>

Dokument i zgjedhësve anonimë: <https://www.electoralcommission.org.uk/i-am-a/voter/register-vote/register-vote-anonymously#>

Dokument i Zgjedhësit Anonim

Nëse nuk keni një formë të pranuar mjeti identifikimi me fotografi mund të aplikoni për një dokument identifikimi votuesi falas, të njohur si certifikatë e autoritetit të votuesit, nëse:

- nuk keni një formë të pranueshme mjeti identifikimi me fotografi
- nuk jeni të sigurt nëse fotografia në mjetin e identifikimit vazhdon të ngjajë me ju
- keni merak të përdorni një formë ekzistuese të mjetit të identifikimit për ndonjë arsye tjetër, si për shembull përdorimi i një identifikimi gjinor

Afati për të aplikuar është ora 17:00 më 24 prill.
Mësoni më shumë në: electoralcommission.org.uk

Mjet identifikimi me fotografi i vjetër

Mund të vazhdoni ta përdorni ende mjetin e identifikimit me fotografi nëse është i vjetër, për sa kohë vazhdon të ngjajë me ju.

Emri në mjetin e identifikimit duhet të jetë i njëjti emër që keni përdorur për t'u regjistruar për të votuar.

Nëse nuk mund të shkoni te qendra e votimit, mund të aplikoni për të votuar me postë ose me prokurë.



2 Me postë:

- Ju do t'i merrni fletët e votimit rreth një javë para ditës së votimit.
- Shënoni votat tuaja dhe kthejini sërish në mënyrë që të vijë para orës 22:00 më 2 maj 2024.
- Mos harroni të plotësoni deklaratën e sigurisë me nënshkrimin dhe datën e lindjes suaj.
- Nëse nuk i ktheni në kohë votat tuaja, ato nuk do të merren parasysh.
- Nëse keni harruar t'i postoni, mund ta çoni votën tuaj postare të plotësuar në cilëndo qendër votimi në qarkun ku jeni regjistruar për të votuar ose në zyrën e regjistrimit elektorale të qarkut tuaj.
- Kur e ktheni votën postare me dorë, do t'ju duhet të plotësoni një formular të shkurtër. Ju lutemi të programoni kohën tuaj për këtë.

Afati për aplikimet e reja të votimeve postare dhe për ndryshimet në votimet postare ekzistuese ose me prokurë është ora 17:00 më 17 prill 2024.

Shkoni në gov.uk/apply-postal-vote ose kontaktoni zyrën e regjistrimit elektorale të qarkut tuaj.



3 Përdorimi i një prokure:

- Nëse nuk jeni në gjendje të shkoni te qendra e votimit, mund t'i kërkonte dikujt që i besoni që të jetë i autorizuari juaj.
- Kjo do të thotë që ky person mund të votojë në emrin tuaj, por do t'ju duhet t'i tregoni se për kë doni të votoni.

Afati për marrjen e aplikimeve të reja për të votuar me prokurë (jo prokurë postare ose prokurë emergjente) është ora 17:00 më 24 prill 2024.

Afati për marrjen e aplikimeve të prokurave të emergjencës është ora 17:00 më 2 maj 2024.

Shkoni në gov.uk/apply-proxy-vote ose kontaktoni zyrën e regjistrimit elektorale të qarkut tuaj.

Mësoni më shumë në londonelects.org.uk

@LondonElects


#LondonVotes

SI TË VOTONI

Do të merrni 3 fletë votimi për të votuar në zgjedhjet e Kryebashkiakut të Londrës dhe të Asamblesë së Londrës.


Kryebashkiaku i Londrës (fleta e votimit ngjyrë rozë):

- Zgjidhni se cili dëshironi të jetë Kryebashkiaku i Londrës.
- **Shënoni [X]** pas kandidatit që dëshironi. Bëni vetëm NJË ZGJEDHJE.
- Në vitet e kaluara ka qenë e mundur të bëni një zgjedhje të dytë për kryetarin e bashkisë. Këtë vit nuk do të jetë më kështu.




Anëtari i Asamblesë së Londrës në Zonën Zgjedhore (fleta e votimit me ngjyrë të verdhë):

- Zgjidhni se cili dëshironi të përfaqësojë zonën tuaj në Asamblenë e Londrës.
- Votoni vetëm për një kandidat.
- **Shënoni [X]** pas zgjedhjes suaj.



Anëtari i Asamblesë në Mbarë Londrën (fleta e votimit ngjyrë portokalli):

- Zgjidhni se cili dëshironi që të përfaqësojë të gjithë Londrën në Asamblenë e Londrës.
- Votoni vetëm një herë.
- **Shënoni [X]** pas zgjedhjes suaj.



MË SHUMË INFORMACION

Në prill 2024, të gjithë personat që janë të regjistruar për të votuar në Londër do të marrin një broshurë votimi. Në të do të tregohen të gjithë kandidatët e Asamblesë së Londrës, duke përfshirë mini-manifestot nga kandidatët për kryetar bashkie që zgjedhin të ofrojnë një të tillë dhe do të përmbajë informacione të rëndësishme se ku dhe si të votoni. Do të vijë së shpejti te dera juaj.

Për më shumë informacion, vizitoni londonelects.org.uk, ose kontaktoni zyrën e regjistrimit elektoral të qarkut tuaj.